

URDHËR
Nr. 1, datë 24.12.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimet publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për miratimin e shpenzimeve për të gjithë artikujt dhe urdhërimin e të gjitha pagesave, urdhrave të prokurimit, pa limit vlere, z. Vildan Kaloshi, me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Delegimi i kompetencave, parashikuar në pikën 1, të këtij urdhri, është për periudhën 24.12.2018 deri në datën 10.1.2019.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Naureda Llagami